



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

KRYETARI I KOMUNËS

01Nr./10462-SCB/2020

Kaçanik;

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale dhe nenit 7 të Rregullores Nr.06/2016 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, Kryetari i Komunës merrë këtë:

V E N D I M

Për themelimin e Komisionit Përkohshëm Komunal për Subvencione

I

Themelohet Komisioni Komunal për subvencione në bujqësi, me këtë përbërje:

- 1.Mustafë Loku, Zyrtar për Bujqësi
2. Fadil Guri, Shef i Zyrës për KKK
- 3.Islam Hasani, Zyrtar Financiar

II

Komisioni Komunal për subvencione ka për detyrë të shqyrtoj dhe nxjerrë rekomandime për Kryetarin e komunës me kërkesat për ndarjen e subvencioneve.

III

Komisioni komunal për Subvencionime duhet të jetë efektiv dhe efikas gjatë ushtrimit të kompetencave, brenda kohës sa më të shkurtër të mundshme të përpiloj rekomadimin për kryetarin e komunës, por jo më gjatë se 15 pune pas përfundimit të afatit të shpalljes publike.

IV

Me këtë vendim të njoftohen: Anëtarët e Komisionit, kryetari i Komunës, Arkivi.

Kryetari i Komunës
z. Besim Ilazi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality of Kaçanik

Zyra e Kryetarit

01Nr. 104/02-7779/20
Kaçanik, 06.03.20

Në mbështetje të neneve 17 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 73 të Statutit të Komunës, pas propozimit të drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, kryetari i komunës nxjerr këtë:

VENDIM

Për formimin e komisionit të përkohshëm


1. Formohet komisioni komunal për implementimin e vendimit të kuvendit komunal për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale pas shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe propozime nga qytetarët e komunës së Kaçanikut 01 Nr. 104/02-1699/20 të dt. 31. 01. 2020.
2. Komisioni komunal për implementimin e këtij vendimi, do të ketë këtë përbërje:
 1. Menduh Krasniqi – Shef i Sektorit të Shërbimeve Publike;
 2. Betim Shala – Zyrtar për Urbanizëm;
 3. Besim Sallahu – Inspektor i Komunikacionit;
3. Komisioni obligohet që në afat sa më të shkurtër kohor, të bëjë vendosjen e shenjave të emërtimeve të rrugëve dhe njëkohësisht të bëjë edhe shënimin në databazën e agjensionit kadastral të Kosovës.
4. Pas përfundimit të punëve të parapara, komisioni harton dhe njofton me një raport me shkrim zyrën e kryetarit, drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave dhe drejtorinë e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.
5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.
6. Me këtë vendim, njoftohen: Anëtarët e Komisionit dhe Arkivi.



Besim Ilazi
Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

KRYETARI I KOMUNËS
01Nr. 104/02-8094 /20
Kaçanik, 09.03.2020

Në bazë të nenit 70 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr.04/2011 për procedurat disiplinore, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit disiplinor të SH.C.K-së

1. Me këtë vendim formohet Komisioni Disiplinor për zhvillimin e procedurës disiplinore dhe marrjen masave në rastet që kanë të bëjnë, me shkelje të rënda të Ligjit të Shërbimit civil apo të akteve nënligjore.
2. Komisioni duhet të jetë i përbërë prej tre antarëve, të cilët do të kenë mandate dy vjeçar me mundësi vazhdimi dhe do të pasqyrojnë diversitetin e shoqërisë kosovare, duke përfshirë sidomos diversitetin gjinor.
3. **Komisioni disiplinor ka këtë përbërje:**
 1. Menduh Krasniqi- Kryetar i komisionit
 2. Mirlinda Dema-anëtar i komisionit
 3. Murat Burrniku - anëtar i komisionit .
4. Komisioni do ta kryej funksionin në pajtim të nenit 70 dhe 71 të Ligjit për Shërbimin civil të Republikës së Kosovës dhe rregulloren Nr.04/2011 për procedurat disiplinore në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.
5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Me këtë vendim njoftohen:

- Anëtarët e komisionit
- Njësia e personelit
- Arkivi komunal

Kryetari i Komunës
Besim Ilazi